

# AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "GOLDEN FARM" SHPK

## AKT THEMELIMI

### I

#### Shoqerise Tregtare Me Pergjegjesi Te Kufizuar "GOLDEN FARM" SHPK

Themeluesi qe firmos me poshte:

**ENDRIT KRASTA** - i biri i Bashkim, i datelindjes 09.10.1979 lindur ne Elbasan dhe banues ne lagja "Shenkoll" Elbasan, i pajisur me leternjoftim me nr. Personal H91009045Q shtetas shqipetar, me zotesi te plote per te vepruar.

Qe ne vijim do te perbeje **Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise.**

Sot me date 28.02.2018 bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosi te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

### KREU 1

#### OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

#### Neni 1

#### Objekti i Shoqerise

Shoqeria do te ushtroje veprimtari me objekt:Krijimi dhe menaxhimi i impianteve te rritjes, perpunimit, therjes, ambalazhimit, etiketimit dhe tregtimit te pulave dhe mishit te pules apo te te gjitha kafsheve, mishi i te cilave tregtohet ne tregun vendas e te huaj, Pulari per mbareshtimin e shpendeve, prodhim te produkteve dhe nenprodukteve te shpendeve, incubator, blerje- shitje, Prodhim vezesh, perpunim i ushqimeve per rritjen e mbareshtimin shpendeve. Tregti me shumice dhe pakive, import, eksport, prodhim, shperndarjen dhe tregtimin e shpendeve dhe produkteve/nenprodukteve te tyre. Krijimin e linjes per rritje e prodhime shpendesh,te nenprodukteve bujqesore e blektorale. Zhvillimi i teknologjive te reja ne fushen e rritjes, perpunimit, therjes dhe tregtimit te pulave dhe mishit te pules apo te te gjitha kafsheve, mishi i te cilave tregtohet ne tregun vendas e te huaj, Import-Eksport i ketyre produkteve, kryesisht pulave te gjalla dhe ato te mishit te pules, te plota apo pjese, nenprodukteve te tyre por edhe produkteve te tjera te te gjitha kafsheve, mishi i te cilave tregtohet ne tregun vendas e te huaj, si psh. mish vici, derri, lope etj., Prodhim, Import- Eksport i nenprodukteve te mishit te te gjitha llojeve te kafsheve si psh: sallameve, qofteve, kotoletave gjysem te gatshme e te gatshme, Import-Eksport i produkteve me te cilat ushqehen te gjitha llojet e kafsheve, Import-Eksport te makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per impiantet e rritjes, perpunimit, therjes dhe tregtimit te pulave dhe mishit te pules apo te te gjitha kafsheve, mishi i te cilave tregtohet ne tregun vendas e te huaj. Import-Eksport I manikerive dhe mjeteve qe sherbejne per prodhimin e nenprodukteve te mishit te te gjitha llojeve te kafsheve si psh.: sallameve, qofteve, kotoletave, gjysem te gatshme etjl Import-Eksport makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per prodhimin e produkteve me te cilat ushqehen te gjitha llojet e kafsheve, Furnizimi dhe tregtimi ne pikat e konsumit dhe tregjet e vendit te te gjitha produkteve qe permenden ne objektin e veprimtarise se Shoqerise Importimi i desifektanteve ushqimore, vaksinave te ndryshme te shpendeve, kafsheve dhe te gjitha produkteve te tjera medicinale te nevojshme per zhvillimin e aktivitetit te saj primar, rritjes se shpendeve.



## **AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "GOLDEN FARM" SHPK**

### **Neni 2**

#### **Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise**

1. Ortaku themelues vendosi qe shoqerine ta emertoje "GOLDEN FARM" sh.p.k
2. Selia Juridike e Shoqerise ndodhet ne **Fshati Vreshtaj Elbasan, Fshati Vreshtaj, Elbasan, Rruga Kryesore Elbasan - Gjinar, Godinë 2 Katëshe, Kati 1, Nr.3**
3. Shoqeria mund te krijojë dege, zyra perfaqesimi e filiale brenda ose jashte territorit te Republikës se Shqiperise.

### **Neni 3**

#### **Regjimi Juridik**

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.
2. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
3. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **KREU II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4**

##### **Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ne ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te tretteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj themeltar dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### **Neni 5**

### **KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pakufizuar.

## **KREU III KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

#### **Neni 6**

Kapitali themeltar eshte **100** (njqind) Leke dhe zoterohet **100** % nga ortaku i vetem  
**ENDRIT KRASTA**





## **AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "GOLDEN FARM" SHPK**

---

### **KREU IV ORGANET E SHOQERISE**

#### **Neni 7**

Vendimet ne shoqeri merren nga Asambleja e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise, eksperti kontabel i autorizuar dhe drejtuesi teknik caktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

### **KREU V ADMINISTRIMI**

#### **Neni 8**

Administrimi i Shoqerise do te behet ne perputhje me Statutin qe i bashkangjitet ketij Akti.

### **KREU VI DISPOZITA TE TJERA**

#### **Neni 9**

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i ndahet Ortakeve te shoqerise sipas pjeseve kontribuese ne kapitalin themeltar.
2. Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

### **ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "GOLDEN FARM" SHPK**

**ENDRIT KRASTA**

